

Vendim nr. 217 datë 20.10.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 20.10.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (T) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: TOM DEDAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2287, datë 21.03.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Tom Dedaj (*kërkuesi*) ka qenë fillimisht me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat dhe më pas në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*KLP*), me vendimin nr. 22, datë 28.01.2019, ka vendosur shkarkimin e kërkuesit nga detyra e prokurorit, pas dënimit me vendim të formës së prerë nga Gjykata për Krime të Rënda për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal (*KP*) dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. Në aplikim të neneve 30, pika 1, 35, 44, paragrafi 2, të *KP*-së është vendosur dhënia e dënimit plotësues, heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike për 1 (një) vit. Në zbatim të nenit 59 të *KP*-së është vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në periudhë provë për 2 (dy) vjet me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.

3. Duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e *KLP*-së, në datën 20.02.2019 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me padi me objekt për disa kërkime, konkretisht: “1. *Shfuqizimin e vendimit për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj*; 2. *Kthimin në detyrën e mëparshme të Prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër*; 3. *Dhënien e pagës nga data 28.01.2019 e në vazhdim*; 4. *Dhënien e një shpërblimi të drejtë në shumën 30.000.000*; 5. *Konstatimin e diskriminimit ndaj paditësit Tom Dedaj*; 6. *Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandatit si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë së anëtarëve Gent Ibrahim, Tartar Bazaj, Bujar Sheshi, Arben Dollapi, Antoneta Sevdari, Besnik Cani, Gentjan Osmani dhe Nurihan Sehataj*; 7. *Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket konstituimit të Këshillit të Prokurorisë*; 8. *Pezullimin e vazhdimin të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor*; 9. *Pezullimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështjeje.*”.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 229, datë 22.10.2019, ka vendosur shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës Administrative të Apelit për shqyrtimin e pikave 1, 2, 3 dhe 9 të objektit të padisë dhe dërgimin e akteve Kolegjit të Posaçëm të Apelit; shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës Administrative të Apelit për shqyrtimin e pikave 4, 5, 6, 7 dhe 8 të objektit të padisë dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin, datë 09.03.2020 ka vendosur të ngrëjë përpara Gjykatës së Lartë çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore dhe funksionale në lidhje me gjykimin e çështjes.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2020-147, datë 26.06.2020, ka vendosur përcaktimin e Gjykatës Administrative të Apelit si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërimit lidhur me anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së KLP-së të datës 19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandateve të anëtarëve të KLP-së, si dhe për konstituimin e tij; përcaktimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërimit për dhënien e shpërblimit në shumën 30.000 lekë dhe konstatimin e diskriminimit ndaj kërkuarit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 229, datë 22.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit lidhur me pjesën e konstatimit të mungesës së kompetencës funksionale për gjykimin e pikave 1, 2, 3 dhe 9 të padisë dhe pushimin e gjykimit të çështjes për këto kërtime.

7. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me kërkesë me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 00-2020-147, datë 26.06.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 96, datë 30.10.2020, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

8. Pas vendimit nr. 00-2020-147, datë 26.06.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka përcaktuar Gjykatën Administrative të Apelit kompetente për shqyrtimin e kërtimeve për konstituimin dhe certifikimin e mandatit të anëtarëve të KLP-së, kjo gjykatë, me vendimin nr. 31, datë 04.05.2022, ka vendosur mospranimin e padisë, duke arsyetuar se kërkuari nuk ka interes të kundërshtojë përbërjen e organit (certifikimin dhe dhënien e mandatit anëtarëve të saj), që ka marrë vendimin e masës disiplinore ndaj tij.

9. Kërkuari ka ushtruar rekurs ndaj vendimit nr. 31, datë 04.05.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2287, datë 21.03.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

10. Kërkuari në datën 23.06.2023 (*data e shërbimit postar*) i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 00-2023-2287, datë 21.03.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për nevoja të shqyrtimit kushtetues është

kërkuar plotësimi i dokumentacionit dhe në datën 24.07.2023 kërkesa është regjistruar përfundimisht.

11. Në lidhje me afatin ligjor 3-mujor për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

II

Pretendimet e kërkuetit

12. *Kërkueti*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

12.1. Cenimin e së drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

12.1.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë duhej të rregullonte shkeljet e kryera nga gjykatat më të ulëta. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk plotësonte kriteret e vendosura për arsytimin e vendimit.

12.1.2. *Së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ligjor*, pasi gjykatat me sjelljen e tyre antikushtetuese kanë shkaktuar vonesë prej 4 vjetësh për gjykimin e çështjes.

12.1.3. *Parimit të paanshmërisë*, pasi kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës së Gjykatës Administrative të Apelit nuk është pranuar, për më tepër në kushtet kur edhe vetë ajo kishte paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes.

12.2. Vendimi i KLP-së për shkarkimin nga detyra të prokurorit është absolutisht i pavlefshëm si në formë, ashtu edhe në përmbajtje.

12.3. Vendimi i Gjykatës së Lartë për ndarjen e kërkimeve, përcaktimi i Gjykatës Administrative të Apelit si kompetente për disa kërkime dhe i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të tjera, nuk është i drejtë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuetit*

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Individit, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000 mund të vërë në lëvizje

Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

14. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që individi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues, do të vlerësohet legjitimitimi i kërkuesit, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Kolegji thekson se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi mund të drejtohet me kërkesë në këtë gjykatë për çështje kur në bazë të normave procedurale, ai ka qenë palë drejtpërdrejt në proces, si dhe plotëson kriterin “detyrimi për të justifikuar interesin”.

16. Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor me objekt anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së KLP-së të datës 19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandatit të anëtarëve të KLP-së, konstituimit dhe pezullimin e vazhdimit të veprimtarisë së saj deri në përfundimin e procesit gjyqësor të çështjes.

18. Në vështrim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, Kolegji konstaton se, në rastin konkret, kërkuesi, në aspektin procedural formal ka qenë palë në procesin gjyqësor, por në aspektin substancial, në kërkesën drejtuar Gjykatës, nuk ka parashtruar argumente kushtetuese për të provuar cenimin real të të drejtave dhe lirive themelore të mbrojtura nga Kushtetuta. Kërkuesi në mënyrë që të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje, duhet të provojë se preket në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vendimi gjyqësor objekt kundërshtimi. Në

këtë kuptim, kërkuesi nuk ka arritur të provojë se cilat janë interesat e tij konkretë që janë prekur nga procesi gjyqësor i përfunduar me vendimin nr. 00-2023-2287, datë 21.03.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se ai nuk legjitimohet *ratione personae* në kërkesën drejtuar Gjykatës.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.